



Lufta në tentativë kundër korrupsionit



Autorët: Leotrim Gashi dhe Anesa Hoxha

Redaktor: Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Korrik, 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive.....	4
2. Politikat anti-korrupsion	5
3. Trajtimi i korrupsionit gjatë vitit 2021	6
4. Rastet kryesore të korrupsionit si dëshmi për dështimin e institucioneve të drejtësisë në luftimin e korrupsionit	9
5. Suksesi i aktakuzave sipas prokurorëve	14
6. Provat e prokurorisë në aktakuzat për korrupsion	17
7. Dënimet plotësuese dhe konfiskimet e pasurisë	19
8. Politika ndëshkimore e rasteve të korrupsionit.....	21

1. Përmbledhja ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) nga viti 2015 e tutje vit pas viti ka nxjerrë raporte të monitorimit sistematik që i ka bërë rasteve të korrupsionit dhe në këto raporte vazhdimisht është pasqyruar dështimi i ndjekjes së mirëfilltë penale dhe politikës së butë ndëshkimore në rastet e aktgjykimeve dënuese, të cilat gjetje më pas janë konfirmuar edhe nga raportet e institucioneve ndërkombëtare. Në raportin e Progresit të vitit 2021 edhe njëherë është theksuar fakti se Kosova është në fazën e hershme të luftimit të korrupsionit.¹ E gjetje të njëjta janë dhënë edhe me Raportin e vitit 2021 për të drejtat e njeriut në Kosovë të Departamentit Amerikan të Shtetit.²

Nga aktgjykimet që janë shpallur gjatë vitit 2021 ndaj 165 personave, janë dënuar vetëm 72 persona kurse ndaj 69 personave apo 42% prej tyre, aktakuzat për korrupsion kanë dështuar të provohen në gjykatë. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë shpallur vendime gjyqësore në shkallë të parë ndaj 28 personave që i takojnë profilit të lartë dhe për të gjithë këtë grup të akuzuar kanë dështuar aktakuzat e prokurorisë. Viti 2021 është njeri nga vitet i cili ka pasur rezultatet më negative të dështimit të rasteve të profilit të lartë, rastet si “Veteranët” apo “Posta” ku dyshohet për dëm të madh ndaj buxhetit të shtetit kanë përfunduar me aktgjykime liruese kurse akoma më keq kanë përfunduar rastet ndaj Ish-Kryetarit të Lipjanit Shukri Buja, Ish-Deputetit Naser Osmani dhe Ish-Sekretarit të Ministrisë së Shëndetësisë Ilir Tolaj, të cilat kanë pushuar për shkak të parashkrimit. Po ashtu në raste të tjera të rëndësishme si rasti ndaj Ish-Kryetarit të Komunës së Gjilanit Qemajl Mustafa dhe Drejtorit të Sekretariatit të KPK-së Lavdim Krasniqi, për shkak të gabimeve në fazën hetimore, provat kryesore janë shpallur të papranueshme.

Duke parë dështimin e aktakuzave të Prokurorit të Shtetit, IKD ka analizuar edhe mënyrën e të provuarit të aktakuzave dhe nga analizimi i 16 aktakuzave, është parë se shumica prej tyre si prova kanë propozuar vetëm dëshmitarë, kurse fare pak masa të fshehta hetuese. Nga kjo analizë është konstatuar se zbatimi më i madh i këtyre masave, ndikon që aktakuzat të jenë të provueshme në gjykatë dhe të akuzuarit të shpallën fajtor. Në krahasim me vitet e kaluara gjatë vitit 2021 është parë ngritje e rasteve të dënimeve plotësuese, të ndalimit të ushtrimit të profesionit, por në mënyrë që qëllimi i dënimeve të korrupsionit të jetë më kuptimplotë, duhet që ky dënim të jepet ndaj zyrtarëve që shpallën fajtor për korrupsion, kurse akoma mbetet shqetësuese mos konfiskimi i pasurisë së fituar me vepra penale të korrupsionit. Nga analizimi i 15 aktgjykimeve dënuese, IKD ka parë se gjykatat kanë injoruar individualizimin e dënimit të përcaktuar me Kodin Penal dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për politikë ndëshkimore dhe se vetëm në një numër shumë të ulët i tyre (3), gjykatat i kanë dënuar me burgim efektiv të akuzuarit.

¹ “Kosovo Report 2021”. European Commission. 19.10.2021. (Shih linkun: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2021-10/Kosovo%202021%20report.PDF>). (Qasur për herë të fundit më 24.06.2022).

² “Raporti i vitit 2021 për të drejtat e njeriut në Kosovë i Departamentit Amerikan të Shtetit”. Departamenti Amerikan i Shtetit. 12.04.2022. (Shih linkun: https://xk.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/133/HRRreportKosovo2021_Alb.pdf). (Qasur për herë të fundit më 24.06.2022).

2. Politikat anti-korrupsion

Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021-2026,³ si një nga dokumentet më të rëndësishme të forcimit të sundimit të ligjit në Kosovë. Sipas kësaj Strategjie si faktor kryesor në mungesën e aktgjykimeve dënuese ndaj të akuzuarve për korrupsion, është konsideruar interpretimi i ndryshëm i dispozitave ligjore nga prokuroria dhe gjykata, mangësitë procedurale në fazën hetimore, kapaciteti i ulët i zyrtarëve policor të angazhuar në ndjekjen e korrupsionit e po ashtu edhe mungesa e specializimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjetjet e njëjta kanë qenë edhe në dokumentet e Rishikimit Funksional të Sundimit të Ligjit. Po ashtu si iniciativa të tjera të Ministrisë së Drejtësisë gjatë vitit 2021 kanë qenë edhe vetingu⁴, krijimi i Byrosë për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë⁵ dhe ndryshimi i ligjit për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave⁶ dhe atij për agjencinë për parandalimin e korrupsionit.⁷ Duhet theksuar se iniciativa për krijimin e Byrosë për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë u kundërshtua nga IKD⁸ me arsyetimin se me këtë ligj shkelet kushtetuta dhe standardet ndërkombëtare, të cilat vlerësime u konfirmuan edhe me opsionin e Komisionit të Venecias për këtë projektligj.⁹

Në anën tjetër, KGJK në tetor të vitit 2021 ka miratuar Planin Strategjik për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar 2022-2024. Me këtë Plan Strategjik KGJK ka synuar që t'i zvogëloj numrin e lëndëve të korrupsionit, duke iu dhënë prioritet absolut.¹⁰ Sipas

³ “Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026”. Qeveria e Kosovës. Korrik 2021. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 06.06.2022).

⁴ Koncept dokumenti për zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë. Ministria e Drejtësisë. Tetor 2021. (Shih linkun: <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/41154-UpdAl.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 10.07.2022).

⁵ Projektligji për byronë shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme. (Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperByroneShtetoreperverifdhekonfiskiminepasurise sepajustific_uEKvJuu4qS.pdf). (Qasur për herë të fundit më 10.07.2022).

⁶ Projektligji për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave. (Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperdeklariminprejardhjenkontrepasurisedhetedhur atave_raE88BJk54.pdf). (Qasur për herë të fundit më 10.07.2022).

⁷ Projektligji për agjencinë për parandalimin e korrupsionit. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/07/PROJEKTLIGJI-PER-AGJENCINE-PER-PARANDALIMIN-E-KORRUPSIONIT.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 10.07.2022).

⁸ “Konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme: problemet juridike të projektligjit aktual” IKD. Janar 2022. (Shih linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/01/IKD_Raporti_Konfiskimi-i-Pasurise-se-pajustificueshme-problemet-juridike-te-projektligjit-aktual-19.01.2022.pdf). (Qasur për herë të fundit më 10.07.2022).

⁹ “Kosovo - Opinion on the Draft Laë N°08/L-121 on The State Bureau for verification and confiscation of unjustified assets, adopted by the Venice Commission at its 131st Plenary Session”. Komisioni i Venecias. 20.06.2022. (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2022\)014-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2022)014-e)). (Qasur për herë të fundit më 10.07.2022).

¹⁰ “Plani Strategjik për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar 2022-2024”. KGJK. 22.10.2021. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/44297_Vendimi_KGJK_se_Nr_292_2021_Miratohet_Plani_Strategjik_per_Zgjidhjen_Efikase_te_Lendeve_te_Korrupsionit_dhe_Krimin_te_Organizuar_2022-2024.pdf). (Qasur për herë të fundit më 10.07.2022).

këtij plani, barra kryesore për përmbushjen e tij i është dhënë kryetarëve të gjykatave. Nga monitorimi i rasteve të korrupsionit në të gjitha gjykatat në Kosovë, IKD ka gjetur se rastet e korrupsionit nuk janë trajtuar me prioritet, por të njëjtat janë duke u trajtuar sipas praktikave të vjetra. Pavarësisht kërkesave të IKD-së, drejtuar KGJK-së lidhur me zbatimin e këtij Plani, për shkak të mungesës së transparencës,¹¹ nuk është kuptuar nëse kryetarët e gjykatave janë duke kryer obligimet e përcaktuara me këtë plan e që janë identifikimi i secilës lëndë të korrupsionit, me të dhënat e secilit rast dhe raportimi me shkrim në fillim të çdo muaji lidhur me zbatimin e këtij Plani. Ndërkaq gjatë vitit 2021 nuk është miratuar ndonjë politikë e re në luftimin e korrupsionit nga ana e KPK-së.

3. Trajtimi i korrupsionit gjatë vitit 2021

Gjatë vitit 2021, nga Prokurori i Shtetit janë ngritur aktakuza ndaj 348 personave për vepra penale të korrupsionit.¹² Po në këtë vit, gjykatat kanë marrë vendime ndaj 165 personave.¹³ 72 persona janë dënuar¹⁴, kurse ndaj 69 personave aktakuzat kanë dështuar të provohen në gjykatat sepse ato kanë marrë aktgjykime liruese apo refuzuese.¹⁵

Nëse krahasohen të dhënat e vitit 2021 me vitet paraprake, rezulton se në shtatë gjykatat themelore janë nxjerrë më pak vendime në rastet e korrupsionit (165 persona) sesa në vitin 2019, kur ishin nxjerrë vendime për 302 persona. Ndërsa, numri i vendimeve të nxjerra gjatë vitit 2021, është përafërsisht i njëjtë me numrin e vendimeve të nxjerra gjatë vitit 2020 (161 persona), gjatë të cilit vit, për shkak të pandemisë Covid-19, puna e gjyqësorit për disa muaj ishte reduktuar vetëm në çështjet urgjente. Kështu, IKD gjenë se gjatë vitit 2021, Gjykatat kanë pasur një efikasitet konsiderueshëm të ulët. Përkatesisht, gjatë këtij viti, gjykatat kanë pasur rezultatin pothuajse të njëjtë me vitin 2020, i cili ishte vit i pandemisë.

Tutje, përpos se viti 2019 ka qenë më produktiv në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit, gjatë këtij viti po ashtu ka pasur më shumë aktgjykime dënuese. Përderisa në vitin 2019 nga totali i vendimeve të shpallura, në 60% prej tyre, personat e akuzuar ishin shpallur fajtor për korrupsion, në vitin 2021 janë shpallur fajtor vetëm 44% e të akuzuarve.¹⁶ Kështu, krahas efikasitetit të ulët të

¹¹ *Shënim:* IKD më 15 mars 2022 ka pranuar një përgjigje nga KGJK sipas së cilës është caktuar koordinatori për zbatimin e këtij Plani, por nuk kanë treguar se a është vepruar sipas kërkesave të këtij Plani. IKD përsëri më 7 qershor 2022 ka dërguar kërkesë për informata rreth zbatimit të Planit por nuk ka marrë përgjigje dhe për shkak të heshtjes së KGJK-së, ka ushtruar ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

¹² Përgjigja e zëdhënësit të KPK-së Astrit Kolaj për IKD-në, në formë elektronike. 23.03.2022


¹³ Përgjigja e zëdhënësës së KGJK-së Ajshe Qorraj për IKD-në, në formë elektronike. 24.03.2022

¹⁴ *Shënim:* Nga 72 personat e dënuar, 22 persona janë dënuar me burgim, 31 me gjobë dhe 6 persona me kusht.

¹⁵ *Shënim:* Përpos aktgjykimeve dënuese, liruese dhe refuzuese, gjatë vitit 2021, ndaj 24 personave rastet janë zgjidhur në mënyra të tjera.

¹⁶ *Shënim:* Në bazë të të dhënave të KGJK-së, dallimi në mes lëndëve të korrupsionit që gjykatat i kanë pasur në punë në vitin 2019 (419) dhe 2021 (383) është vetëm 36 lëndë më pak në punë në vitin 2021, por në vitin 2021 janë zgjidhur vetëm 28% e lëndëve në punë (108), në krahasim me vitin 2019, kur ishin zgjidhur 36% e lëndëve (150).

gjykatave gjatë vitit 2021, edhe numri i aktgjykimeve dënuese gjatë këtij viti ka shënuar regres, si në raport me vitin 2020 ashtu edhe, veçanërisht, në raport me vitin 2019.



Grafiku 1. Trajtimi i rasteve të korrupsionit sipas të dhënave të KGJK-së, për vitet 2019-2021, të shprehura sipas personave.¹⁷

Gjatë vitit 2021, në procedura gjyqësore kanë qenë në proces rastet e 76 personave të profilit të lartë.¹⁸ Lidhur me këto raste, gjykatat themelore kanë marrë aktgjykime ndaj 28 personave. Sikurse në vitet e kaluara¹⁹, as gjatë vitit 2021 nuk është shqiptuar asnjë aktgjykim dënues ndaj ndonjë të akuzuarit të këtij profili. Ndaj 15 personave të profilit të lartë aktakuzat e prokurorisë kanë dështuar të provohen për shkak të mungesës së provave. Në shkallë të parë ishte shpallur aktgjykim lirues ndaj 12 të akuzuarve në rastin “Veteranët”²⁰ dhe tre të akuzuarve në rastin “Posta”²¹. Ndërsa, për 13 të akuzuar të cilët i takojnë profilit të lartë, të cilët bëjnë pjesë në rastin e “Hidrocentraleve” është hedhur aktakuza akoma pa filluar shqyrtimi gjyqësor për shkak të parashkrimit relativ të veprës penale.²²

¹⁷ *Shënim:* Te personat e padënuar, janë llogaritur aktgjykimet liruese dhe refuzuese, kurse te totali i vendimeve janë llogaritur edhe vendimet ndaj 24 personave, rastet e të cilëve janë zgjidhur në mënyra të tjera.

¹⁸ *Shënim:* Profili i lartë është përcaktuar sipas udhëzuesit të KPK-së, të miratuar më 3 nëntor 2013 nga Kryeprokurori i Shtetit Ismet Kabashi.

¹⁹ “Dënimi i korrupsionit si kundërvajtje”. IKD. Prill 2021. Nëntor 2020 (Shih linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/IKD_Raporti-D%C3%ABnimet-plot%C3%ABSues-2.pdf). (Qasur për herë të fundit më 10.07.2022).

²⁰ “Shpallet aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve në rastin e njohur “Veteranët”. Betimi për Drejtësi. 19.01.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-aktgjykim-lirues-ndaj-te-akuzuarve-ne-rastin-e-njohur-veteranet/>). (Qasur për herë të fundit më 06.06.2022).

²¹ “Tre ish-drejtesit e PTK-së lirohen nga akuzat për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 21.09.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-aktgjykim-lirues-ndaj-te-akuzuarve-ne-rastin-e-njohur-veteranet/>). (Qasur për herë të fundit më 06.06.2022).

²² “Afera e hidrocentraleve”, Gjykata e Apelit e lë në fuqi aktakuzën ndaj Besim Beqajt, Mimoza Kusarit dhe katër të akuzuarve tjerë”. Betimi për Drejtësi. 18.05.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/afere-e-hidrocentraleve-gjykata-e-apelit-e-le-ne-fuqi-aktakuzen-ndaj-besim-beqajt-mimoza-kusarit-dhe-kater-te-akuzuarve-tjere/>). (Qasur për herë të fundit më 07.06.2022).

Kështu, gjetjet e IKD-së flasin për një mungesë efikasiteti dhe mungesë të rezultateve të sistemit të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit. Duke parë rezultate të tilla të dështimeve të vazhdueshme të aktakuzave për korrupsion ndaj zyrtarëve të profilin të lartë, mund të konstatohet se luftimi i korrupsionit i profilin të lartë vetëm përmes ngritjes së aktakuzave mbetet vetëm në tentativë e jo edhe luftim i plotë i korrupsionit. Edhe në raportet ndërkombëtare, vazhdon të theksohet fakti se në këtë fushë mendojnë rezultatet konkrete.²³

3.1. Aktakuzat ndaj profilin të lartë në vitin 2021

Por për dallim nga viti 2019 kur Prokurori i Shtetit kishte ngritur vetëm dy aktakuza për korrupsion të profilin të lartë dhe viti 2020 kur kishte ngritur tri aktakuza të tilla, gjatë vitit 2021 është shënuar ngritje e rasteve të aktakuzave të reja ndaj profilin të lartë. Kjo pasi gjatë këtij viti, Prokurori i Shtetit ka ngritur gjashtë aktakuza në të cilat janë akuzuar 13 persona të profilin të lartë. Nëse nuk e marrim parasysh provimin e aktakuzave në gjykatë, mund të konstatohet se gjatë vitit 2021, Prokurori i Shtetit ka shënuar rezultat më pozitiv në ndërmarrjen e veprimeve për luftimin e korrupsionit të profilin të lartë.

Në këtë grup të personave janë përfshirë ish-Ministrja e Integritetit Evropian, Dhurata Hoxha²⁴ dhe ish-Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, në të cilën aktakuzë bënë pjesë edhe ish-Kryetari i Komunës së Malishevës „Ragip Begaj²⁵, derisa Begaj gjatë vitit 2021 është akuzuar për korrupsion edhe në një rast tjetër.²⁶ Një tjetër kryetar komune që është akuzuar për korrupsion në vitin 2021, është ish-Kryetari i Komunës së Leposaviqit. Dragan Jabllanoviq.²⁷

Dy raste të tjera të korrupsionit të profilin të lartë në të cilat është ngritur aktakuzë gjatë vitit 2021, janë edhe rastet ndaj një zyrtari të Ministrisë së Financave dhe një biznesmeni, që dyshohen se kanë përvetësuar mbi dy milion euro nga buxheti i shtetit²⁸ si dhe ndaj ish-Sekretarit të Ministrisë së Infrastrukturës, Elmi Reçica dhe tre zyrtarëve të tjerë të kësaj ministrie, të cilët dyshohen për

²³ “Kosovo Report 2021”. European Commission. 19.10.2021. (Shih linkun: <https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/system/files/2021-10/Kosovo%202021%20report.PDF>). (Qasur për herë të fundit më 10.07.2022).

²⁴ “Ish-ministrja Dhurata Hoxha dhe të tjerët nuk e pranojnë fajësinë për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 01.09.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-ministrja-dhurata-hoxha-dhe-te-tjeret-nuk-e-pranojne-fajesine-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 06.06.2022).

²⁵ “Prokuroria Speciale thotë se ka prova ndaj ish-ministrit të MTI-së, ish-kryetarit të Malishevës dhe të tjerëve, mbrojtja pretendon të kundërtën”. Betimi për Drejtësi. 21.02.2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-speciale-thote-se-ka-prova-ndaj-ish-ministrit-te-mti-se-ish-kryetarit-te-malisheves-dhe-te-tjereve-mbrojtja-pretendon-te-kunderten/>). (Qasur për herë të fundit më 06.06.2022).

²⁶ “Kryetari i Malishevës deklarohet i pafajshëm për korrupsion në rastin e ndërtimit të një shkolle”. Betimi për Drejtësi. 05.08.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-malisheves-deklarohet-i-pafajshem-per-korrupsion-ne-rastin-e-ndertimit-te-nje-shkolle/>). (Qasur për herë të fundit më 06.06.2022).

²⁷ “Gjykimi për korrupsion e krim të organizuar, deklarohen të pafajshëm ish-kryetari Leposaviqit dhe të tjerët”. Betimi për Drejtësi. 25.02.2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-korrupsion-e-krim-te-organizuar-deklarohen-te-pafajshem-ish-kryetari-leposaviqit-dhe-te-tjeret/>). (Qasur për herë të fundit më 06.06.2022).

²⁸ “Deklarohen të pafajshëm dy të akuzuarit për vjedhjen e mbi 2 milionë eurove nga Thesari i Shtetit”. Betimi për Drejtësi. 26.10.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-dy-te-akuzuarit-per-vjedhjen-e-mbi-2-milione-eurove-nga-thesari-i-shtetit/>). (Qasur për herë të fundit më 06.06.2022).

korrupsion lidhur me tenderin e autostradës së Gjilanit, ku pretendohet të jetë shkaktuar dëm mbi gjashtë milion euro.²⁹

4. Rastet kryesore të korrupsionit si dëshmi për dështimin e institucioneve të drejtësisë në luftimin e korrupsionit

Mënyra e dështimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit dëshmohet përmes disa rasteve të cilat ilustrjnë mënyrën se si trajtohen rastet e korrupsionit, posaçërisht ato që i takojnë profilit të lartë. Viti 2021 është karakterizuar si vit në të cilin për shkak të mos trajtimit me kohë të rasteve të mëdha të korrupsionit, rastet janë parashkruar dhe në këtë mënyrë kanë përfunduar pa u marrë vendim meritot mbi fajësinë e tyre³⁰. Po ashtu, raste të mëdha të korrupsionit kanë dështuar edhe për faktin se provat kryesore me të cilat prokuroria ka synuar t'i provoj pretendimet e saja, janë shpallur të papranueshme. Po ashtu, problem i vazhdueshëm i trajtimit të rasteve të korrupsionit, është edhe zvarritja e madhe e këtyre lëndëve, që përpos mos respektimit të të drejtave të të pandehurve për gjykim në kohë të arsyeshme ndikon edhe në (nëse vërtetohen pretendimet e prokurorisë) rritjen e dëmit ndaj buxhetit të shtetit.

❖ Rrëzimi i provave kryesore të aktakuzave për korrupsion

Korrupsioni në prokurimin publik, apo siç njihet ndryshe “korrupsioni me tender”, nga shpallja e pavarësisë e tutje ka qenë një nga format më të shpeshta përmes të cilave është pretenduar se zyrtarët e shtetit kanë ardhur shpejtë te pasurimi i kundërligjshëm. Lidhur me dyshimet se Komuna e Gjilanit është përfshirë në këtë lloj korrupsioni, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), më 16 shtator 2016 kishte ngritur aktakuzë kundër Ish-Kryetarit të kësaj komune **Qemajl Mustafa** dhe 35 personave të tjerë, duke i ngarkuar ata me veprat penale “krim i organizuar”, “shpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar” si dhe “keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi”.

Për këtë rast nga viti 2019 e tutje sistemit të drejtësisë i është dashur shumë angazhim të resurseve të saj për shkak se ky rast ka kaluar një fazë të gjatë të procesit të konfirmimit të aktakuzës. Pas konfirmimit të aktakuzës, dhe pas 23 seancave të caktuara, 12 nga të cilat në vitin 2021, shkalla e parë ka vendosur t'i liroj të gjithë të akuzuarit, për shkak se provat kryesore të këtij rasti e që ishin përgjimet që i inkriminonin të akuzuarit, është konsideruar nga gjykata se janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin.³¹ Kjo për faktin se në shkresat e lëndës ka munguar kërkesa e prokurorisë për lëshimin e urdhërësës për masat e fshehta të përgjimit, e cila kërkesë nuk gjendej as nga ana e Prokurorisë. Por anomalia më e madhe është edhe fakti se si Ish-Gjykata e Qarkut të Gjilanit, ka

²⁹ “Ish-sekretari i MI-së dhe tre zyrtarët tjerë deklarohen të pafajshëm lidhur me akuzat për dallavere në tenderin për Autostradën e Gjilanit” Betimi për Drejtësi. 15.04.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-sekretari-i-mi-se-dhe-tre-zyrtaret-tjere-deklarohen-te-pafajshem-lidhur-me-akuzat-per-dallavere-ne-tenderin-per-autostraden-e-gjilanit/>). (Qasur për herë të fundit më 06.06.2022).

³¹ “Qemajl Mustafa dhe të akuzuarit tjerë lirohen nga akuzat për korrupsion me tenderë dhe krim të organizuar”. Betimi për Drejtësi. 13.04.2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/qemajl-mustafa-dhe-te-akuzuarit-tjere-lirohen-nga-akuzat-per-korrupsion-me-tendere-dhe-krim-te-organizuar/>). (Qasur për herë të fundit më 09.06.2022).

lëshuar urdhëresë për përgjime pa kërkesë të prokurorisë. Në këtë mënyrë, pyetja legjitime të cilës nuk i është dhënë përgjigje është nëse nuk ka ekzistuar fare një kërkesë e tillë apo e njëjta është zhdukur gjatë zhvillimit të procedurës.³²Në anën tjetër, gjykata po ashtu ka konstatuar se në këtë rast në kundërshtim me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale urdhëresa është lëshuar në vitin 2012, por pa pasur dyshim të bazuar për të pandehurit, kurse hetimet kishin filluar në vitin 2015, e po ashtu se masat e përgjimit janë lëshuar vetëm ndaj tre personave, kurse janë përgjuar edhe 36 persona të tjerë.

Në këtë mënyrë, përderisa prova kryesore në këtë rast është konstatuar se është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, i bie se një vendim i tillë do të mund të merrej në fazën e konfirmimit të aktakuzës dhe nëse do të ndodhte kjo, potencialisht aktakuza të rrëzohej pa u zhvilluar fare shqyrtimi maratonik gjyqësor.³³

Gabimet në fazën hetimore të hetimit të korrupsionit përpos rastit të Qemajl Mustafës kanë ndodhur edhe në një rast tjetër në të cilin është i implikuar zyrtari më i lartë i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK). Drejtori i Sekretariatit të KPK-së **Lavdim Krasniqi**, së bashku me dy zyrtarë të tjerë të KPK-së, në gusht të vitit 2021 janë akuzuar për disa vepra penale të korrupsionit.³⁴

Mirëpo aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, nuk ka mundur të kalojë plotësisht në fazën e konfirmimit të aktakuzës. Edhe në këtë rast prova kryesore me të cilën prokuroria ka synuar të provojë se Krasniqi është fajtor për veprat për të cilat është akuzuar, që ishte një CD që përmbante një video-incizim të takimit të Krasniqit me një dëshmitar bashkëpunues të prokurorisë, është shpallur e papranueshme me vendim të formës së prerë. Sipas gjykatës së shkallës së dytë, gjyqtari i procedurës paraprake ka lëshuar urdhrin për incizim në kundërshtim me procedurën e paraprakë me Kodin e Procedurës Penale. Pra në këtë rast, kërkesa dhe urdhri është lëshuar ndaj personave NN, edhe pse është ditur se kush është pista e hetimit.³⁵ Aktualisht gjykimi është në fazën e shqyrtimit gjyqësor, por për shkak të gabimeve në zbatimin e ligjit, gjykimi për këtë rast do të zhvillohet pa u administruar prova, që prokuroria e konsideronte kryesore.

³² “Betimi për Drejtësi 275: Dështimi i Prokurorisë në shkallë të parë: Rasti Qemajl Mustafa”. Betimi për Drejtësi. 16.04.2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejtesi-275-deshtimi-i-prokurorise-ne-shkalle-te-pare-rasti-qemajl-mustafa/>). (Qasur për herë të fundit më 07.07.2022).

³³ *Shënim*: Ky rast akoma gjendet në shkallën e parë pasi aktgjykimi është në fazën e përpilimit të aktgjykimit. Sipas një përgjigje të zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Pejë, Tringa Zhuti më 07.07.2022, pas kërkesës së kryetares së trupit gjykues, gjyqtarës Nushe Kuka-Mekaj, Kryetari i Gjykatës, e ka lejuar shtyrjen e përpilimit të aktgjykimit deri më 13 korrik 2022 dhe se përpilimi i aktgjykimit është në përpilim.

³⁴ “Prokuroria ngritë aktakuzë për korrupsion ndaj Lavdim Krasniqit dhe të tjerëve” Betimi për Drejtësi. 13.08.2021. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ngrite-aktakuze-per-korrupsion-ndaj-lavdim-krasniqit-dhe-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 07.06.2022).

³⁵ “Arsyetimi i Apelit që la në gjykim Lavdim Krasniqin për korrupsion” Betimi për Drejtësi. 13.08.2021. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/arsyetimi-i-apelit-qe-la-ne-gjykim-lavdim-krasniqin-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 08.06.2022).

❖ *Parashkrimi i korrupsionit të nivelit të lartë*

Ish-Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, **Naser Osmani** dhe pesë ish-zyrtarë të tjerë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), janë akuzuar në vitin 2015 për korrupsion, me pretendimin se përmes keqpërdorimit të pozitës zyrtare, i kanë shkaktuar dëm buxhetit të shtetit mbi pesë milion euro. Por pasi rasti as pas një procesi të rigjyqimit nuk kishte marrë një aktgjykim meritor, pas shumë dështimeve të seancave në vitin 2021, në fillim të janarit të vitit 2022, rasti ka arritur parashkrimin absolut dhe ndaj tyre është pushuar procedura.³⁶

Ish-kryetari i Komunës së Lipjanit, **Shukri Buja** është njëri nga pak personat e profilit të lartë ndaj të cilit ishin shqiptuar dy aktgjykime dënuese nga gjykata e shkallës së parë me të cilat ai ishte dënuar me burgim efektiv, por pasi Buja e kishte dërguar lëndën në Gjykatën Supreme, kjo gjykatë e kishte kthyer rastin në rivendosje. Nga dyshimi për kryerjen e veprës penale e deri te ngritja e aktakuzës për këtë rast Prokurorisë i ishin dashur gati gjashtë vite, ndërkaq për katër vite të tjera, ky rast ishte gjykuar dy herë nga gjykata e shkallës së parë, tri herë nga shkalla e dytë e një vendim ishte marrë edhe nga Gjykata Supreme, por pavarësisht gjithë këtyre vendimeve, rasti ndaj tij nuk është arritur të përfundoj me një aktgjykim përfundimtar, pasi më 7 mars 2021 vepra për të cilën akuzohej Buja, ka arritur afatin e parashkrimit absolut.³⁷

Për arsye të njëjta si Buja e Osmani, akuzat për korrupsion kanë mbetur pa një vendim përfundimtar edhe ndaj Ish-Sekretarit të Ministrisë së Shëndetësisë, **Ilir Tolaj**. Ai me aktakuzën e prokurorisë të vitit 2012 ishte akuzuar për korrupsion në 10 pika të aktakuzës dhe pas gjashtë aktgjykimeve (tri nga shkalla e parë dhe tri nga shkalla e dytë), në asnjërën prej tyre nuk u provua se është fajtor pasi që në këtë rast kishte arritur afati i parashkrimit e në disa të tjera ai është liruar me aktgjykim të formës së prerë. Në vitin 2021, në një proces të dytë të rigjyqimit, Tolaj ngarkohej me vetëm një pikë të aktakuzës por aktgjykimi ndaj tij ishte marrë në fund të vitit 2021, me të cilin ai u lirua nga aktakuza, por 21 ditë pas këtij aktgjykimi, rasti ndaj tij ka arritur afatin e parashkrimit dhe procedura penale ndaj tij kishte pushuar.³⁸

Rasti “**Hidrocentralet**”, është një tjetër rast i profilit të lartë, me të cilin demonstron në mënyrë të qartë se si Prokurori i Shtetit, në emër të luftës kundër korrupsionit të profilit të lartë, akuzon 19 persona, mirëpo për 13 nga ta, aktakuza ishte e vdekur për shkak se kishte arritur afati i parashkrimit relativ dhe për këtë arsye gjykata e ka hedhur aktakuzën ndaj tyre në procedurën e

³⁶ “Për shkak të parashkrimit, refuzohet aktakuza për korrupsion ndaj Naser Osmanit dhe te tjerëve lidhur me privatizimin e ndërmarrjes “FAN”. Betimi për Drejtësi. 23.02.2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/per-shkak-te-parashkrimit-refuzohet-aktakuza-per-korrupsion-ndaj-naser-osmanit-dhe-te-tjereve-lidhur-me-privatizimin-e-ndermarrjes-fan>). (Qasur për herë të fundit më 07.06.2022).

³⁷ “Vendos Apeli, Shukri Bujës i vjetërsohet lënda ku akuzohej për korrupsion” Betimi për Drejtësi. 07.05.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/vendos-apeli-shukri-bujes-i-vjetersohet-lenda-ku-akuzohej-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 07.06.2022).

³⁸ “Apeli refuzon akuzën për korrupsion ndaj Ilir Tolajt, shkak arritja e parashkrimit më 12 janar të këtij viti”. Betimi për Drejtësi. 07.05.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-refuzon-akuzen-per-korrupsion-ndaj-ilir-tolajt-shkak-arritja-e-parashkrimit/>). (Qasur për herë të fundit më 07.06.2022).

konfirmimit të aktakuzës, pra akoma pa filluar shqyrtimi gjyqësor.³⁹ Pra, në këtë rast, Prokurori i Shtetit kishte ngritur aktakuzë të parashkruar ndaj 13 personave. Duhet theksuar se dëmi i pretenduar në këtë rast është 13,682,166.41 euro.

Fati i 13 të akuzuarve, të cilët i pret edhe katër ish ministrat dhe dy zyrtarët e tjerë, nëse ky rast nuk përfundohet me aktgjykim të formës së prerë deri më 8 maj 2023, që është data kur për të njëjtit arrin parashkrimi absolut.⁴⁰

IKD vlerëson se mundësia që të ndodhë parashkrimi edhe për ish-ministrat është shumë e madhe. Kjo duke pasur parasysh se rasti aktualisht është një fazë të hershme të gjyqimit dhe praktika e deritanishme flet për një trajtim të ngadaltë të këtyre rasteve. Pavarësisht rrezikut për parashkrim, Gjykata nuk është duke e trajtuar me prioritet këtë rast. Gjatë gjithë vitit 2021, Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë, për këtë rast kishte caktuar vetëm shtatë seanca, dy nga të cilat ishin shtyrë.^{41 42}

❖ *Dëmtimi i buxhetit nga zvarritja e procesit i buxhetit*

Zvarritja e rasteve të korrupsionit ndikon në rritjen e vazhdueshme të dëmit ndaj buxhetit të shtetit. Një nga rastet kryesore me të cilat sipas pretendimeve të PSRK-së, buxhetit të shtetit i shkaktohet çdo muaj mbi tre milion euro,⁴³ është rasti “**Veteranët**”, në të cilin për akuza për korrupsion akuzohen ish-kryeministri Agim Çeku, ish-ministra, ish-deputet e ish-kryetar të komunave.

Ata akuzohen se duke keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, për kohën sa ishin pjesë e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së UÇK-së, ia kanë njohur kundërligjshëm të drejtën e statusit të veteranëve luftëtar 19.500 personave. Gjykata Themelore në Prishtinë, më 19 janar 2021 ka shpallur aktgjykim me të cilin të gjithë të akuzuarit i ka liruar nga aktakuza, me arsyetimin se

³⁹ “*Afera e hidrocentraleve*”, Gjykata e Apelit e lë në fuqi aktakuzën ndaj Besim Beqajt, Mimoza Kusarit dhe katër të akuzuarve tjerë”. Betimi për Drejtësi. 18.05.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-e-pafajshme-zyrtarja-e-be-se-e-akuzuar-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 07.06.2022).

⁴⁰ *Shënim*: IDK në dhjetor të vitit 2021 ka publikuar raportin “*Korrupsioni në prag të vjetërsimit*”, me të cilin është pasqyruar se gjatë vitit 2022 dhe 2023 mund të parashkruhen rastet e korrupsionit ndaj 23 personave. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-e-pafajshme-zyrtarja-e-be-se-e-akuzuar-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 08.06.2022).

⁴¹ “*Mungon Dardan Gashi, shtyhet gjykimi në rastin e njohur si “Afera e hidrocentraleve”*” 21.09.2021. Betimi për Drejtësi. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-dardan-gashi-shtyhet-gjykimi-ne-rastin-e-njohur-si-afere-e-hidrocentraleve/>). (Qasur për herë të fundit më 08.06.2022).

⁴² *Mungon Mimoza Kusari-Lila, dështon të mbahet seanca e së mërkurës në rastin e njohur si “Afera e hidrocentraleve”* Betimi për Drejtësi. 10.11.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-mimoza-kusari-lila-deshton-te-mbahet-seanca-e-se-merkures-ne-rastin-e-njohur-si-afere-e-hidrocentraleve-2/>). (Qasur për herë të fundit më 08.06.2022).

⁴³ *Shënim*: Sipas aktakuzës së PSRK-së, PPS.nr.12/2018, të datës 07.12.2018, është përcaktuar që me veprimet e të akuzuarve, buxhetit të shtetit, për çdo muaj i shkaktohet dëm në vlerë prej 3,315.00 euro.

prokuroria nuk e ka dëshmuar me prova pretendimin e saj⁴⁴, kurse Gjykata e Apelit më 26 prill 2022, ka njoftuar se kjo Gjykatë për shkak të shkeljeve të ligjit nga shkalla e parë, këtë rast e ka kthyer në rigjykim.⁴⁵

Duke marrë parasysh se sipas PSRK-së, buxhetit të shtetit për çdo muaj i shkaktohet dëm në vlerë prej 3,315,000.00 euro, për shkak të pagesave të pensioneve për 19,500 veteran luftëtarë që kanë fituar këtë status kundërligjshëm, i bije se nga fillimi i vitit 2015 e deri në fund të qershorit të vitit 2022, ky dëm ka arritur vlerën në 298,350,000 euro. Ndërkaq vetëm nga ngritja e aktakuzës e deri në qershor të këtij viti, kanë kaluar dy vite e gjysmë dhe rasti tashmë është në pritje të një procesi të rigjykimit, që nuk është caktuar akoma,⁴⁶ dhe vetëm sa rasti është trajtuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Gjykata e Apelit, duke u bazuar në pretendimet e prokurorisë, buxheti i shtetit është dëmtuar për 99,450,000 euro, e cila shumë, sipas këtyre pretendimeve, rritet për çdo muaj me nga 3,315,000 euro derisa të merret një aktgjykim i formës së prerë.

❖ *Stagnimi i rastit “Toka”*

Një rast tjetër i korrupsionit të profilit të lartë është rasti i njohur si **“Toka”** në të cilin për krim të organizuar dhe vepra të tjera penale, duke përfshirë edhe ato të korrupsionit janë duke u akuzuar ish-deputeti Azem Sylja dhe 18 persona të tjerë. Aktakuza për këtë rast ishte ngritur në tetor të vitit 2016, me të cilën pretendohet se më shumë se 50 persona kanë bashkëpunuar për të përvetësuar prona shtetërore te personat fizik dhe duke i shkaktuar dëm buxhetit të shtetit për 30 milionë euro.

Shqyrtimi gjyqësor në këtë rast kishte filluar në janarin e vitit 2018, por edhe pse për këtë rast janë ndryshuar pesë gjykatës dhe janë caktuar 30 seanca gjyqësore⁴⁷, tash kur kanë kaluar gati gjashtë vite nga ngritja e aktakuzës, ky proces është akoma në fazën fillestare të gjykimit. Ky rast ishte afër përfundimit gjatë vitit 2020, por për shkak se kryetari i trupit gjykues ishte avancuar në Gjykatën e Apelit, rasti ka kaluar te një gjyqtar tjetër dhe procesi do të nisë nga pika zero. Pavarësisht rëndësisë së trajtimit të këtij rasti, Gjykata Themelore në Prishtinë, jo që nuk ka mbajtur por as nuk ka caktuar asnjë seancë gjyqësore gjatë vitit 2021.⁴⁸

⁴⁴ “Shpallet aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve në rastin e njohur “Veteranët” Betimi për Drejtësi.19.01.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-aktgjykim-lirues-ndaj-te-akuzuarve-ne-rastin-e-njohur-veteranet/>). (Qasur për herë të fundit më 08.06.2022).

⁴⁵ “Rasti “Veteranët”, Apeli ka gjetur se Themelorja vërtetoi në mënyrë të gabuar faktin më thelbësor që ka të bëjë me miratimin e listave nga komisioni”. Betimi për Drejtësi.19.01.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-apeli-ka-gjetur-se-themelorja-vertetoi-ne-menyre-te-gabuar-faktin-me-thelbesor-qe-ka-te-beje-me-miratimin-e-listave-nga-komisioni/>). (Qasur për herë të fundit më 08.06.2022).

⁴⁶ “Gazmend Bahtiri caktohet kryetar i Trupit gjykues në rastin “Veteranët”, nuk dihet data e seancës fillestare”. Betimi për Drejtësi.05.06.2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gazmend-bahtiri-caktohet-kryetar-i-trupit-gjykues-ne-rastin-veteranet-nuk-dihet-data-e-seances-fillestare/>). (Qasur për herë të fundit më 08.06.2022).

⁴⁷ *Shënim*: Nga 30 seanca të caktuara, nga monitorimi i IKD-së është raportuar se 17 prej tyre kanë dështuar të mbahen.

⁴⁸ “Rasti “Toka”, shembull i dështimit të sistemit të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”. Betimi për Drejtësi.05.06.2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-toka-shembull-i-deshhtimit-te-sistemit-te-drejtises-ne-luften-kunder-korrupsionit-dhe-krimit-te-organizuar/>). (Qasur për herë të fundit më 08.06.2022).

5. Suksesi i aktakuzave sipas prokurorëve

Në mënyrë që të bëhet identifikimi i suksesit të aktakuzave të prokurorëve veç e veç, IKD ka hulumtuar (mos) suksesin e aktakuzave sipas prokurorëve që kanë ngritur këto aktakuza. Këtu, janë analizuar aktakuzat e prokurorëve në rastet kur gjykatat kanë shpallur vendime për dy apo më shumë aktakuza të prokurorëve, në të cilat janë akuzuar më shumë se tre persona.

Me këtë rast, IKD gjenë se në mesin e prokurorëve, ka dallime të theksuara sa i përket suksesit të aktakuzave të tyre. Përkatësisht, ka prokurorë që shumica apo të gjitha aktakuzat e tyre për korrupsion kanë dështuar dhe e kundërta, prokurorë që shumica apo të gjitha aktakuzat e tyre kanë pasur sukses në gjykatë. Në vijim, janë paraqitur shembuj konkret të dallueshmërisë së suksesit të aktakuzave sipas prokurorëve që i kanë ngritur këto aktakuza.

Gjykata e shkallës së parë ka marrë dy aktgjykime lidhur me aktakuzat e ngritura nga prokurorja e PSRK-së, Fikrije Fejzullahu. Ndaj njërit të akuzuar gjykata ka refuzuar akuzën për shkak të parashkrimit, kurse dy të tjerë janë liruar për shkak të mungesës së provave.⁴⁹ Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjiilan, Arben Kadriu, që aktualisht udhëheq me këtë prokurori ka ngritur katër aktakuza në të cilat janë përfshirë shtatë persona. Vetëm dy nga ta janë shpallur fajtor⁵⁰ kurse pesë të tjerë janë liruar nga akuza.⁵¹

Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë Dulina Hamiti, ka ngritur katër aktakuza me gjashtë persona, për të cilat janë shpallur aktgjykime gjatë vitit 2021. Ndaj katër personave gjykatat

⁴⁹ “Për shkak të parashkrimit, shpallet aktgjykim refuzues në rastin për korrupsion ndaj ish-zyrtarit të Drenasit”. Betimi për Drejtësi. 08.10.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/per-shkak-te-parashkrimit-shpallet-aktgjykim-refuzues-ne-rastin-per-korrupsion-ndaj-ish-zyrtarit-te-drenasit/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022). “Lirohen nga akuza mjeku dhe infermieri të akuzuar për marrje ryshfeti dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 08.12.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/lirohen-nga-akuza-mjeku-dhe-infermieri-te-akuzuar-per-marrje-ryshfeti-dhe-keqpërdorim-te-detyres-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022). Ky vendim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit më 10.05.2022.

⁵⁰ “Dënohet me 5 mijë euro gjobë zyrtari komunal i Gjiilanit, i akuzuar për falsifikim të dokumenteve të tatimpaguesve”. Betimi për Drejtësi. 05.11.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-5-mije-euro-gjobe-zyrtari-komunal-i-gjiilanit-i-akuzuar-per-falsifikim-te-dokumente-te-tatimpaguesve/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022). “Dënim unik me 3000 euro gjobë për marrje ryshfeti ndaj rojës së pyllit në Viti”. Betimi për Drejtësi. 01.06.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denim-unik-me-3000-euro-gjobe-per-marrje-ryshfeti-ndaj-rojes-se-pyllit-ne-viti/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022).

⁵¹ “Gjykata liron nga akuza dy të akuzuarit për korrupsion dhe mashtrim me subvencione”. Betimi për Drejtësi. 03.12.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-liron-nga-akuza-dy-te-akuzuarit-per-korrupsion-dhe-mashtrim-me-subvencione/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022). “Për të katërtën herë, Gjykata shpall aktgjykim lirues ndaj ish-drejtorit të Urbanizmit në Gjiilan dhe inspektorëve të ndërtimit (Video)”. Betimi për Drejtësi. 22.04.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/per-te-katerten-herë-gjykata-ne-gjiilan-shpall-aktgjykim-lirues-ndaj-ish-drejtorit-te-urbanizmit-ne-gjiilan-dhe-inspektoreve-te-ndertimit-video/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022).

kanë marrë aktgjykime liruese⁵², kurse vetëm ndaj dy personave janë shpallur aktgjykime dënuese, pasi të akuzuarit e kishin pranuar fajësinë.⁵³

Gjykata Themelore në Gjilan, gjatë vitit 2021 ka shpallur katër aktgjykime për rastet të cilat janë iniciuar me aktakuzat e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Shaban Spahiu. Në këto aktakuza akuzoheshin gjashtë persona. Tre nga këta persona janë dënuar⁵⁴, kurse tre të tjerë janë liruar nga akuza.⁵⁵ Nga katër aktakuza e ngritura nga prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Njazi Rexha, me të cilat akuzoheshin katër persona, Gjykata Themelore në Mitrovicë ka marrë dy aktgjykime dënuese⁵⁶, një aktgjykim lirues⁵⁷ dhe një tjetër refuzues, për shkak se prokurori ishte tërhequr nga ndjekja penale.⁵⁸

⁵² “Lirohen nga akuzat dy ish-ekspertët OSHP-së, akuzoheshin për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 20.12.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/lirohen-nga-akuzat-dy-ish-ekspertet-oshp-se-akuzoheshin-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022). “Zyrtari policor lirohet nga akuza për korrupsion dhe manipulim me prova”. Betimi për Drejtësi. 15.11.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/zyrtari-policor-lirohet-nga-akuza-per-korrupsion-dhe-manipulim-me-prova/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022). Ky rast është kthyer në rigjykim më 07.02.2022. “Shpallet i pafajshëm roja i pyllit që akuzohet se mori 20 euro ryshfet”. Betimi për Drejtësi. 12.04.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-roja-i-pyllit-qe-akuzohet-se-mori-20-euro-ryshfet/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022). Gjykata e Apelit e ka vërtetuar këtë vendim më 27.09.2021.

⁵³ “6 muaj burgim me kusht dhe 500 euro gjobë ndaj agentit të shitjes që akuzohet se përvetësoi mbi 4 mijë euro”. Betimi për Drejtësi. 15.07.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/6-muaj-burgim-me-kusht-dhe-500-euro-gjobe-ndaj-agentit-te-shitjes-qe-akuzohet-se-pervetesoi-mbi-4-mije-euro/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022). “Dënohet me 1,800 euro gjobë, pasi e pranoi se dha 2,500 euro për t’u punësuar në KEK”. Betimi për Drejtësi. 17.05.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-1800-euro-gjobe-pasi-e-pranoi-se-dha-2500-euro-per-tu-punesuar-ne-kek/>). (Qasur për herë të fundit më 13.06.2022).

⁵⁴ “Dënohet me 4 mijë euro gjobë dhe 8 muaj burg se i shkaktuan dëm mbi 16 mijë euro Autoritetit Pyjor në Kamenicë”. Betimi për Drejtësi. 22.10.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-4-mije-euro-gjobe-dhe-8-muaj-burg-se-i-shkaktuan-dem-mbi-16-mije-euro-autorititet-pyjor-ne-kamenice/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022). “5 mijë e 100 euro gjobë ndaj të akuzuarit që pranoi se ka paraqitur dokumentacion të rremë për të plotësuar kriteret për fitim të tenderit”. Betimi për Drejtësi. 22.07.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/5-mije-e-100-euro-gjobe-ndaj-te-akuzurit-qe-pranoi-se-ka-paraqitur-dokumentacion-te-rreme-per-te-plotesuar-kriteret-per-fitim-te-tenderit/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

⁵⁵ “Lirohen nga akuza e korrupsionit tre inspektorët e Kamenicës”. Betimi për Drejtësi. 22.09.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/lirohen-nga-akuza-per-korrupsion-inspektorret-e-tregut-ne-kamenice/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

⁵⁶ “Dënohet me 4 mijë euro gjobë për korrupsion kryeshefi i kompanisë së mbeturinave “Uniteti” në Mitrovicë”. Betimi për Drejtësi. 30.06.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-4-mije-euro-gjobe-per-korrupsion-ish-kryeshefi-i-kompanise-se-mbeturinave-uniteti-ne-mitrovice/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022). “Pas rigjykimit të tretë, ish-zyrtari i gjendjes civile në Leposaviq dënohet me një vit burgim me kusht për keqpërdorim të detyrës”. Betimi për Drejtësi. 27.05.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjykimit-te-trete-ish-zyrtari-i-gjendjes-civile-ne-leposaviq-denohet-me-nje-vit-burgim-me-kusht-per-keqperdorim-te-detyres/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

⁵⁷ “Aktgjykim lirues ndaj të akuzuarit për korrupsion në Mitrovicë”. Betimi për Drejtësi. 26.03.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-lirues-ndaj-te-akuzuarit-per-korrupsion-ne-mitrovice/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

⁵⁸ “Prokuroria tërhiqet nga ndjekja penale, aktgjykim refuzues ndaj të akuzuarit për përvetësim të rreth 20 mijë eurove”. Betimi për Drejtësi. 20.02.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-terhiqet-nga-ndjekja-penale-aktgjykim-refuzues-ndaj-te-akuzuarit-per-pervetesim-te-rreth-20-mije-eurove/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

Nga katër aktakuza që i ka ngritur prokurorja e Prokurorisë Themelore në Prizren Ervehe Gashi, në të cilat akuzoheshin katër persona, gjykata e shkallës së parë gjatë vitit 2021 ka gjetur fajtor tre nga këta të akuzuar⁵⁹, kurse nuk ka gjetur përgjegjësi penale ndaj një personi tjetër.⁶⁰

Një nga prokurorët më të suksesshëm në provimin e aktakuzave për korrupsion gjatë vitit 2021 ka qenë prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Genc Nixha. Nga tri aktakuzat e ngritura nga ai, në të cilat janë akuzuar tre persona, gjykata i ka shpallur fajtor të gjithë të akuzuarit.⁶¹

Në gjashtë aktakuza të ngritura nga prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Mehdi Sefa, ku akuzoheshin nëntë persona, Gjykata Themelore në Prizren gjatë vitit 2021 ka shpallur fajtor gjashtë nga ta⁶², kurse ka liruar tre të akuzuar të tjerë.⁶³

⁵⁹ “Shtetasi i Shqipërisë dënohet me gjobë e burgim me kusht për dhënie të 50 eurove ryshfet, dëbohet edhe nga territori i Kosovës për 3 vite”. Betimi për Drejtësi. 21.04.2021. (Shih linkun <https://betimiperdrejttesi.com/shtetasi-i-shqiperise-denohet-me-gjobe-e-burgim-me-kusht-per-dhenie-te-50-eurove-ryshfet-debohet-edhe-nga-territori-i-kosoves-per-3-vite/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022). Redison Cara. Pkr.nr.165/2021. Aurel Biba. Pkr.nr.264/2021

⁶⁰ “Ish-inspektori i tregut në Prizren lirohet nga akuza për keqpërdorim detyre”. Betimi për Drejtësi. 06.03.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/ish-inspektori-i-tregut-ne-prizren-lirohet-nga-akuza-per-keqpërdorim-detyre/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

⁶¹ “Dënohet me 600 euro gjobë shtetasi i Shqipërisë, pranoi se ia dha 10 euro ryshfet policit në Vërmicë”. Betimi për Drejtësi. 06.03.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/denohet-me-600-euro-gjobe-shtetasi-i-shqiperise-pranoi-se-ia-dha-10-euro-ryshfet-policit-ne-vermicë/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022). “Dënohet me 6 muaj burgim për korrupsion ish-inspektori i Hidro-ekonomisë në Prizren”. Betimi për Drejtësi. 24.12.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/denohet-me-6-muaj-burgim-per-korrupsion-ish-inspektori-i-hidro-ekonomise-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022). *Shënim*: Në rastin me nr të lëndës Pkr.nr. 34/2021, i akuzuari Bashkim Haxhiu, ka lidhur lidhur marrëveshje për praninë fajësie dhe është dënuar me 300 euro gjobë dhe dënim me kusht prej një viti burgim.

⁶² “Dënohet me 6,500 euro gjobë ish-inspektori i Prizrenit i akuzuar për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 04.06.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/denohet-me-6500-euro-gjobe-ish-inspektori-i-prizrenit-i-akuzuar-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022). “8 muaj burg për gjeodetin e akuzuar se kundërligjshëm ndau një tokë, lirohet e akuzuara tjetër”. Betimi për Drejtësi. 15.11.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/denohet-me-8-muaj-burgim-gjeodeti-i-akuzuar-se-ka-bere-ndarjen-e-tokes-pa-lejen-e-njerit-vella/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022). “2 vite e 4 muaj burgim me kusht për korrupsion ndaj ish-drejtorit të Financave dhe zyrtarit të Komunës së Dragashit” Betimi për Drejtësi. 09.12.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/2-vite-e-4-muaj-burgim-me-kusht-per-korrupsion-ndaj-ish-drejtorit-te-financave-dhe-zyrtarit-te-komunes-se-dragashit/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022). “Akuzoheshin për korrupsion, dënohen me burgim me kusht dy ish-drejtorët e Komunës së Prizrenit”. Betimi për Drejtësi. 18.01.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/akuzoheshin-per-korrupsion-denohen-me-burgim-me-kusht-dy-ish-drejtorët-e-komunes-se-prizrenit/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

⁶³ “Lirohet nga akuza për korrupsion ish-drejtori i Urbanizimit në Prizren”. Betimi për Drejtësi. 21.09.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/lirohet-nga-akuza-per-korrupsion-ish-drejtori-i-urbanizimit-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022). Gjykata e Apelit e ka kthyer në rigjykim më 01.03.2022 “Shpallet e pafajshme zyrtarja ligjore e MMPH-së, e akuzuar për korrupsion (Video)”. Betimi për Drejtësi. 03.06.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/shpallet-e-pafajshme-zyrtarja-ligjore-e-mmph-se-e-akuzuar-per-korrupsion-video/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022). Gjykata e Apelit e ka vërtetuar më 26.10.2021. “8 muaj burg për gjeodetin e akuzuar se kundërligjshëm ndau një tokë, lirohet e akuzuara tjetër”. Betimi për Drejtësi. 15.11.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/denohet-me-8-muaj-burgim-gjeodeti-i-akuzuar-se-ka-bere-ndarjen-e-tokes-pa-lejen-e-njerit-vella/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

Prokurori/ja	Prokuroria	Aktgjykime dënuese sipas personave	Aktgjykime liruese apo refuzuese sipas personave
Fikrije Fejzullahu	Prishtinë (Aktualisht në PSRK)	0	3
Arben Kadriu	Gjilan	2	5
Dulina Hamiti	Prishtinë	2	4
Shaban Spahiu	Gjilan	3	3
Njazi Rexha	Mitrovicë	2	2
Ervehe Gashi	Prizren	3	1
Mehdi Sefa	Prizren	6	3
Genc Nixha	Prizren	3	0

Tabela 1. Efikasitetit i aktakuzave për korrupsion sipas prokurorëve.

6. Provat e prokurorisë në aktakuzat për korrupsion

Në mënyrë që IKD të identifikoj se me çfarë provash Prokurori i Shtetit është duke i ngritur aktakuzat për korrupsion, për qëllime të këtij raporti, IKD ka analizuar 16 aktakuza të ngritura nga PSRK dhe shtatë prokuroritë themelore.⁶⁴

Nga këto 16 aktakuza të analizuar, IKD ka gjetur se vetëm në tri raste prokuroritë kanë aplikuar masat të fshehta me rastin e zhvillimeve të hetimeve, e dy nga to përpos masave të fshehta si prova shtesë kanë pasur edhe ekspertiza, kurse në gjashtë raste prokuroritë janë bazuar në ekspertiza.⁶⁵

Ndërsa, pjesa më e madhe e aktakuzave⁶⁶ (9) si prova kanë propozuar vetëm dëshmitë e dëshmitarëve, të pandehurve dhe prova të tjera si raporte policore, procesverbale të hetimit, vendime gjyqësore e shkresa të tjera. Në këtë grup të aktakuzave, në një rast prokuroria nuk ka propozuar fare dëshmitarë, por se vetëm ka propozuar leximin e deklaratave të dëshmitarëve të dhënë në prokurori dhe provave të tjera të siguruara në fazën hetimore.⁶⁷

⁶⁴ *Shënim:* IKD për qëllime të këtij kapitulli ka analizuar nga dy (2) aktakuza të secilës prokurori, të cilat janë përzgjedhur në mënyrë rastësore.

⁶⁵ Aktakuzat PP/I.nr.106/21 dhe PPS.nr.88/20 përpos masave të fshehta kanë propozuar edhe ekspertiza.

⁶⁶ PP.I.Nr.11K/2021, PP/I.Nr.90K/2020, PP/I.Nr.18/20, PP.I.Nr.217/21, PP/I.nr.212/21, PP.I.Nr.38/17, PP.I.nr.218/19, PP/I.nr.139/20 dhe PP/I.nr.219/2021.

⁶⁷ PP/I.nr.212/21.

Ngritja e aktakuzave duke u bazuar vetëm në dëshmitarë, raporte policore, deklarata etj. më tepër i ngjan një hetimi administrativ se sa një hetimi penal në rastet e korrupsionit. Nisur nga fakti se korrupsioni, veçanërisht ai i profilit të lartë, është kategori komplekse e veprave penale dhe supozohet se kryhet me një planifikim të madh, kjo kategori kriminale nuk mund të trajtohet me llojet e njëjta të provave të cilat përdoren në rastet e tjera.

Ndër të tjera, aplikimi i teknikave të veçanta hetuese është edhe obligim sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit⁶⁸. Kështu, IKD vlerëson se Prokurori i Shtetit duhet të ndërroj fokusin në hetimin e rasteve të korrupsionit duke mos u fokusuar vetëm në prova të cilat mund të cilësohen si të zakonshme.

IKD vlerëson se zbatimi i masave të fshehta në rastet e korrupsionit është ndër mënyrat më efektive të luftimit të korrupsionit, në mënyrë që aktakuzat e ngritura të provohen në gjykatë. Kjo është vërtetuar edhe nga analizimi i 16 aktakuzave, ku në të tri rastet në të cilat janë zbatuar masat e fshehta, në dy prej tyre gjykatat kanë marrë aktgjykim dënues të formës së prerë pasi të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë,⁶⁹ kurse në një rast të akuzuarin janë në fazën e negocimit të marrëveshjes për pranim të fajësisë.⁷⁰

⁶⁸ “Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”. 2004, neni 50. (Shih linkun: https://www.unodc.org/documents/brussels/UN_Convention_Against_Corruption.pdf). (Qasur për herë të fundit më 10.07.2022).

⁶⁹ PP/I.nr.171/21. “Apeli vërteton dënimin prej 2 mijë 700 euro gjobë ndaj policit që mori 250 euro ryshfet”. Betimi për Drejtësi. 15.11.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-prej-2-mije-700-euro-gjobe-ndaj-policit-qe-mori-250-euro-ryshfet/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022). PP/I.nr.171/2021. “Apeli ia vërteton dënimin rojës së burgut që mori ryshfet për të transferuar të burgosurin në burgun gjysmë të hapur”. Betimi për Drejtësi. 15.11.2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-ia-verteton-denimin-rojes-se-burgut-qe-mori-ryshfet-per-te-transferuar-te-burgosurin-ne-burgun-gjysme-te-hapur/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

⁷⁰ PPS.nr.88/20. “Mbrojtja dhe prokuroria fillojnë negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, anulohet gjykimi për vjedhjen e mbi 2 milionë eurove nga Thesari i Shtetit”. Betimi për Drejtësi. 13.06.2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-dhe-prokuroria-fillojne-negocimin-e-marreveshjes-per-pranimin-e-fajesise-anulohet-gjykimi-per-vjedhjen-e-mbi-2-milione-eurove-nga-thesari-i-shtetit/>). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).


7. Dënimet plotësuese dhe konfiskimet e pasurisë

Një ndër mënyrat më efikase për luftimin efektiv të korrupsionit në rastet kur vërtetohen pretendimet e prokurorisë se të akuzuarit kanë kryer vepra penale të korrupsionit, janë shqiptimet e dënimeve plotësuese dhe konfiskimi i pasurisë së fituar me vepra penale.

IKD vit pas viti ka gjetur se gjykatat nuk kanë zbatuar dënimin plotësues të mos ushtrimit të funksioneve publike⁷¹ dhe për këtë arsye në vazhdimësi ka kërkuar që gjykatat në rastet kur vërtetojnë fajësinë e të akuzuarve të shpallin edhe këtë dënim plotësues⁷². Edhe me Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për korrupsionin zyrtar, të vitit 2021, kërkohet që gjykatat ta zbatojnë këtë dënim plotësues në rastet e korrupsionit. Sipas këtij udhëzuesi dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të profesionit kërkon një ndalim të përgjithshëm të ushtrimit të funksionit në administratën ose shërbimin publik.⁷³

Gjatë monitorimit të IKD-së gjatë vitit 2021, është gjetur se nga 67 aktgjykime dënuese për korrupsion, vetëm ndaj 24 personave është shqiptuar dënim plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksionit në administratën publike. Shprehur në përqindje i bie se dënim plotësues është shqiptuar në vetëm 35.82% të aktgjykimeve dënuese.

Por, përkundër faktit se aplikimi i dënimeve plotësuese ende nuk është në nivelin e dëshiruar aplikimi i këtyre dënimeve gjatë vitit 2021 ka shënuar rritje të konsiderueshme, çka paraqet një hap pozitiv, por ende të pamjaftueshëm:



Grafiku 2. Krahasimi në mes shqiptimit të dënimeve plotësuese nga gjykatat themelore në vitin 2020 dhe 2021.

⁷¹ “Mungesa e dënimeve plotësuese në luftimin e kriminalitetit”. IKD. Nëntor 2020 (Shih linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/IKD_Raporti-D%C3%ABnimet-plot%C3%ABSuese-2.pdf/). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

⁷² “Dënimi i korrupsionit si kundërvajtje”. IKD. Prill 2021. Nëntor 2020 (Shih linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/IKD_Raporti-D%C3%ABnimet-plot%C3%ABSuese-2.pdf/). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

⁷³ “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”. Gjykata Supreme. Qershor 2021. Faqe 50. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/98248_UDHEZUESI%20PER%20VEPRAT%20E%20KORRUPSIONIT-10%20qershor%202021.pdf). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

Tutje, nga analizimi i 16 aktakuzave të ngritura nga Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2021, IKD ka gjetur se ky organ në rastet e aktakuzave për korrupsion, në vetëm pesë raste⁷⁴ ka propozuar që të akuzuarve tu shqiptohen si dënim plotësuese ndalimi i ushtrimit të funksioneve publike.

Shprehur në përqindje i bie se Prokurori i Shtetit në vetëm 31.25 % të rasteve ka kërkuar nga gjykata shqiptimin e dënimit plotësues, përkundër faktit se barra e shqiptimit të dënimeve plotësuese bie mbi gjykatën, IKD vlerëson se edhe Prokurori i Shtetit duhet të luaj rol in e tij, në kuptim të propozimit dhe argumentimit në gjykatë mbi nevojën e shqiptimit e dënimit plotësues për mos ushtrim të funksioneve publike.

Në anën tjetër, situatë jo e mirë qëndron edhe në raport me konfiskimin e pasurisë së fituar me vepra penale, ku nga të gjitha aktgjykimet dënuese, gjykatat kanë konfiskuar pasuri vetëm ndaj gjashtë personave.

Gjykatat në një rast kanë konfiskuar një shtëpi në sipërfaqe prej 298 m², garazhin me sipërfaqe prej 30 m² dhe një veturë të tipit “Landrover” , në një rast kanë konfiskuar shumën prej 1,845 euro, në dy raste shumat nga 50 euro dhe nga një rast shumat prej 30, përkatësisht 10 euro. Kështu, IKD gjenë se vlerë relativisht e lartë është konfiskuar vetëm në një rast, derisa në pesë rastet e tjera vlera e konfiskimit është shumë e ulët. Kështu, sikurse në vitet e kaluara⁷⁵, edhe gjatë vitit 2021, nuk janë shënuar rezultate të theksuara në konfiskimin e pasurisë së përfituar përmes veprës penale.

⁷⁴ *Shënim:* Aktakuzat e analizuar nga IKD, me të cilat është propozuar dënimi plotësues. 1. PPS.nr.88/20. 2. PP.I.Nr.217/21. 3. PP.I.Nr.141/19. 4. PP/I.nr.139/20. 5. PP/I.nr.171/21.

⁷⁵ “*Lufta për statistika të korrupsionit*”. IKD. Qershor 2020. (Shih linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/IKD_Raporti-D%C3%ABnimet-plot%C3%ABsuese-2.pdf). (Qasur për herë të fundit më 10.07.2022).I “*Dënimi i korrupsionit si kundërvajtje*”. IKD. Prill 2021. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/06/1.-RAPORTI-VJETOR-I-KORRUPSIONIT-2019-IKD-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 10.07.2022).

8. Politika ndëshkimore e rasteve të korrupsionit

Me qëllim të pasqyrimin sa më të saktë të politikës ndëshkimore nga Gjykatat Themelore në Kosovë ndaj veprave penale të korrupsionit, IKD ka analizuar 15 aktgjykime të shpallura gjatë vitit 2021, të publikuara në web faqen e gjyqësorit⁷⁶, të cilat janë përzgjedhur në mënyrë rastësore.

Në këto 15 aktgjykime të analizuara janë të përfshirë 19 persona të cilët janë dënuar për vepra korruptive. Ndaj tyre janë shqiptuar gjithsej 23 dënime. Nga analizimi i këtyre aktgjykimeve IKD ka gjetur se dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurve janë kryesisht me gjobë. Dënimet me gjobë në këto raste janë kryesisht (10 aktgjykime) raste kur fillimisht është shqiptuar dënim me gjashtë muaj burgim efektiv por me pëlqimin e të akuzuarit ky dënim është shndërruar në gjobë.⁷⁷

Nga 15 aktgjykime të analizuara, IKD gjenë se me dënim me burgim efektiv janë dënuar vetëm tre persona, ku njëri është dënuar me 18 muaj burgim efektiv⁷⁸, një me 12 muaj⁷⁹ si dhe një me tetë muaj burgim efektiv.⁸⁰ Me dënim me gjashtë muaj burgim me kusht janë dënuar pesë persona⁸¹, kurse me dënim me gjobë prej 4,000 eurosh si dënim të vetëm është dënuar vetëm një person.⁸²

Në këto aktgjykime është analizuar nëse gjykatat e kanë zbatuar në praktikë udhëzuesin për Politikë Ndëshkimore të miratuar në vitin 2018 nga Gjykata Supreme e Kosovës⁸³ me ç'rast IKD ka gjetur se në asnjërën nga aktgjykimet e analizuara nuk ka pasur përputhje të plotë me kërkesat e këtij udhëzuesi.

Me rastin e matjes së lartësisë së dënimit në aktgjykimet e analizuara nga IKD është gjetur se gjykatësit kanë aplikuar 55 rrethana lehtësuese. Me këtë rast, IKD e sheh si shumë problematike mënyrën e aplikimit të këtyre rrethanave. Kjo pasi vetëm 10 prej këtyre rrethanave lehtësuese janë arsyetuar në aktgjykimet e gjykatave, ndërsa në rastet e tjera të njëjtat vetëm se janë cituar, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore.⁸⁴

Madje në njërën nga këto raste të analizuara IKD ka gjetur se gjykata ka përdorur si rrethanë lehtësuese “moshën relativisht të re”, rrethanë kjo e cila fare nuk ekziston dhe atë kjo rrethanë

⁷⁶ PKR.nr.362/18, PKR.nr.1098/20, PKR.nr.144/16, PKR.nr.896/2020, PKR.nr.125/2021, PKR.nr.32/2019, PKR.nr.96/2020, PKR.nr.16/2020, PKR.nr.61/2019, PKR.nr.92/2018, PKR.nr.41/19, PKR.nr.95/21, PKR.nr.134/21, PKR.nr.177/2021, PKR.nr.199/21.

⁷⁷ PKR.nr.1098/20, PKR.nr.896/2020, PKR.nr.125/2021, PKR.nr.32/2019, PKR.nr.96/2020, PKR.nr.61/2019, PKR.nr.92/2018, PKR.nr.41/19, PKR.nr.134/21.

⁷⁸ Me aktgjykimin PKR.nr.177/2021 i akuzari përpos dënimit me burgim është dënuar edhe me 1,000 euro gjobë.

⁷⁹ Me aktgjykimin PKR.nr.199/21, njeri i akuzuar është dënuar me një vit burgim efektiv.

⁸⁰ PKR.nr.16/2020.

⁸¹ *Shënim*: Njeri nga të dënuarit me kusht është dënuar edhe me 500 euro gjobë. Aktgjykimi PKR.nr.362/18.

⁸² PKR.nr.95/21

⁸³ “Udhëzues për politikën ndëshkimore”. Gjykata Supreme. Prishtinë 2018. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

⁸⁴ Po aty. Faqe 190.

është përdorur për të pandehurin i cili në marrjen e aktgjykimit ka pasur të mbushura 30 vjet.⁸⁵ Në të njëjtin aktgjykim, IKD ka gjetur gjykata edhe ka shumëfishuar rrethanat personale si rrethanë lehtësuese pasi ka përcaktuar se i akuzuari ka shprehur keqardhje dhe pendimin, ka pranuar fajësinë dhe përsëri se është thellë i penduar. Si rrethanë lehtësuese ka përfshirë rrethanat e tij personale dhe familjare e përpos kësaj i ka përfshirë si rrethana të veçanta edhe sjelljen e tij korrekte gjate shqyrtimit gjyqësor, , karakteri i tij si dhe sjellja e tij pas kryerjes se veprës penale, ku të gjitha këto sipas udhëzuesit hyjnë në kuadrin e rrethanave personale.⁸⁶

Edhe përkundër faktit se gjykatat ndaj 15 personave kanë shqiptuar dënime në kufirin minimal të përcaktuar me ligj, në këto aktgjykime IKD ka gjetur se vetëm ndaj tre personave, aktgjykimet kanë elaboruar rrethanat posaçërisht lehtësuese, që kanë ndikuar për këto vendime.

Sa i përket rrethanave rënduese në analizimin e këtyre 15 aktgjykimeve IKD ka vërejtur se në shtatë prej aktgjykimeve gjykatësit me rastin e matjes së lartësisë së dënimit nuk kanë gjetur fare rrethana rënduese.⁸⁷ Ndërsa në katër aktgjykime si rrethanë rënduese gjykatësit kanë përmendur shkallen e përgjegjësisë penale dhe të rrezikut shoqëror si dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur e që këto sipas udhëzuesit nuk janë fare rrethana rënduese, por janë parime të cilat gjykata duhet ti ketë parasysh me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit.⁸⁸ Gjykatësit me rastin e aplikimit të rrethanave rënduese, në vetëm tri raste i kanë arsyetuar këto rrethana.⁸⁹

Kur jemi tek qëllimi i dënimit, në vetëm në një rast qëllimi nuk është përmendur fare por se edhe kur janë përmendur, të njëjtat vetëm janë konstatuar pa u arsyetuar fare nga gjykata, ashtu siç e parasheh udhëzuesi.⁹⁰ IKD ka gjetur se gjykatat nuk ka vlerësuar dhe caktuar peshën e së cilës rrethanë të pranishme, duke i krahasuar dhe baraspeshuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe duke vlerësuar nëse ka në dispozicion rregullime shtesë siç parashihet në udhëzues.⁹¹

Po ashtu është vërejtur se këto aktgjykime kryesisht kanë përmbajtur vetëm veprime procedurale të cilat janë ndërmarrë gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe në fund me më së shumti gjysmë faqe i është referuar matjes së lartësisë së dënimit.

⁸⁵ PKR.nr.362/18.

⁸⁶ “Udhëzues për politikën ndëshkimore”. Gjykata Supreme. Prishtinë 2018. Faqe 48. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

⁸⁷ PKR.nr.1098/20, PKR.nr.125/2021, PKR.nr.96/2020, PKR.nr.16/2020, PKR.nr.95/21, PKR.nr.134/21, Në aktgjykimin PKR.nr.199/21 gjykata ka gjetur një rrethanë rënduese vetëm për njërin të akuzuar, kurse për tjetrin jo.

⁸⁸ PKR.nr.362/18, PKR.nr.896/2020, PKR.nr.32/2019 dhe PKR.nr.61/2019.

⁸⁹ PKR.nr.144/16, PKR.nr.177/2021 dhe PKR.nr.199/2021.

⁹⁰ “Udhëzues për politikën ndëshkimore”. Gjykata Supreme. Prishtinë 2018. Faqe 33. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 21.06.2022).

⁹¹ Po aty. Faqe 190.